



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.08.2022, ora 10.00

**Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

#### **Rendi i Ditës:**

*Vijohet me procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve Znj. Holta Zaçaj, Z. Ilir Toska dhe Znj. Manjola Xhaxho, për vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 21.02.2019, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe 15.11.2021*

#### **Marrin pjesë:**

- |                          |                     |
|--------------------------|---------------------|
| 1. Sokol Binaj           | (kryetar)           |
| 2. Marsida Xhaferllari   | (zëvendës kryetare) |
| 3. Elsa Toska            | (anëtare)           |
| 4. Anila Leka            | (anëtare)           |
| 5. Edlira Petri          | (anëtare)           |
| 6. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare)           |
| 7. Enton Dhimitri        | (anëtar)            |
| 8. Etien Kapo            | (anëtar)            |

**HAPET MBLEDHJA: ora 10.00**

**Kryetari Sokol Binaj-** Çelim mbledhjen e KED të caktuar ditën e sotme në vijim të asaj të ditës së djeshme, të vlerësimit të pikëzimit dhe renditjes së tre kandidatëve aplikues në vakancën e shpallur nga Gjykata e Lartë për anëtare të Gjykatës Kushtetuese të tre kandidatëve Xhaxho, Toska dhe Zaçe, verifikojmë prezencën e anëtarësisë. Të pranishëm Marsida Xhaferllari, zonja Leka, z. Toska, zonja Petri, Mema, zoti Xholi, Dhimitri, zoti Kapo, dhe unë Binaj.

Është komunikuar për paraqitjen e ekspertës së caktuar ditën e djeshme për të realizuar vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaj për Xhaxho dhe Zaçaj, dhe është depozituar në sekretarinë e KED mendimet opinionet për të dy kandidatet, të lexoj opinionin për kandidaten Zaçaj me nr. prot 562 datë 11.08.2022 në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me këtë përmbajtje:

*Lexohet përmbajtja e opinionit të ekspertës mbi vlerësimin e zotërimit të gjuhës së huaj zj. Holta Zaçaj*

*Lexohet përmbajtja e opinionit të ekspertës mbi vlerësimin e zotërimit të gjuhës së huaj për kandidaten zj. Manjola Xhaxho, protokolluar pranë sekretarisë së KED me nr. 563 datë 11.08.2022*

Vijojmë me pjesëmarrjen është i pranishëm Avokati i Popullit, i cili ka njoftuar paraprakisht për paraqitjen pak me vonese ne mbledhje,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi tërhiqet në dhomën e këshillimit për vlerësimin e pikëzimit të kandidatëve dhe më pas me renditjen përfundimtare për secilin prej tyre,

*Ndërpritet mbledhja për tu tërhequr anëtarët e KED në dhomë këshillimi*

KED në përfundim të konkluzioneve të dhomë këshillimi, lidhur me vlerësimin pikëzimin e kandidatëve arriti ne konkluzionin te vlerësoje kandidaten

Kandidaten Holta Zaçaj përfundimisht me 82.2 Pikë

Kandidaten Manjola Xhaxho 83.34 Pikë

Kandidatin Ilir Toska 85.44 Pikë

*Mbledhjen e konsiderojmë të mbyllur.*

**Tiranë me datë 11.08.2022**

**KRYETAR**

**Sokol BINAJ**

